

Znj. Albulena Haxhiu  
U. D. Presidente e Republikës së Kosovës

8 prill 2026

E nderuara U.D. Presidente e Republikës së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu,

Duke marrë parasysh situatën e krijuar lidhur me përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila ka mbetur e papërmbyllur gjatë mandatit të ish-Presidentes Osmani, ju drejtohem me kërkesën për procedimin e emërimit të anëtarit të dytë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës.

Siç është theksuar edhe më herët nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përfaqësimi ynë me dy anëtarë në KQZ nuk është çështje e interpretimit politik, por një e drejtë që buron nga dispozitat kushtetuese. Në këtë kuadër, vlerësojmë se është me rëndësi të vepruhet në përputhje me këtë përcaktim, duke garantuar funksionimin e rregullt dhe kushtetues të institucioneve.

Në cilësinë tuaj si U.D. Presidente dhe garantuese e rendit kushtetues, kërkojmë t'i ushtroni kompetencat tuaja në përputhje me Kushtetutën, me qëllim të procedimit pa vonesë të këtij emërimi.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë rëndësinë e respektimit të praktikës së deritanishme institucionale, sipas së cilës PDK ka qenë e përfaqësuar me dy anëtarë në KQZ, si dhe të parimeve të barazisë dhe balancës ndërmjet subjekteve politike.

Referuar nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, shpërndarja e vendeve në KQZ bazohet në përfaqësimin e grupeve parlamentare në Kuvend. Në rrethanat aktuale, ku ekzistojnë katër grupe parlamentare, një shpërndarje e tillë nënkupton që secili grup të përfaqësohet me nga një anëtar në raundin e parë, ndërsa dy vendet e mbetura të ndahen në bazë të madhësisë së grupeve parlamentare. Kjo qasje siguron përfaqësim proporcional dhe të drejtë.

Besojmë se një interpretim i kujdesshëm dhe në përputhje me frymën e Kushtetutës kontribuon në ruajtjen e besimit publik dhe integritetit institucional të KQZ-së, si një institucion kyç për proceset zgjedhore në vend.

Në këtë frymë, ju ftojme të veproni në përputhje me Kushtetutën dhe praktikën institucionale, duke garantuar respektimin e të drejtave të të gjitha subjekteve politike dhe funksionimin e qëndrueshëm të institucioneve.

Me respekt,

**Bedri Hamza**  
Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës

